

VENDIM
Nr.79, datë 2.2.2011

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE NDËRMJET FEDERATËS
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT DHE MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE, ME QËLLIM RINDËRTIMIN, MODERNIZIMIN
DHE ADMINISTRIMIN E STADIUMIT KOMBËTAR “QEMAL STAFA”¹**

(Ndysbuar me VKM nr.715, datë 16.10.2012; nr.1092, datë 18.12.2015; nr.728, datë 8.12.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e pëlqimit për krijimin e një shoqërie anonime aksionare, me qëllim rindërtimin, modernizimin dhe administrimin e stadiumit kombëtar “Qemal Stafa”, si objekt sportiv.

1/1. Projekti dhe ndërtimi i modernizuar i Stadiumit Kombëtar “Qemal Stafa” të ketë një destinacion të dyfishtë.

Pjesa qendrore e projektit dhe ndërtimit të ketë destinacion sportiv, publik, të pandryshueshëm, në përputhje me parametrat e Rregullores së Infrastrukturës së Stadiumeve të UEFA-s, botim i vitit 2010, (UEFA Stadiums Infrastructure Regulations, 2010 Edition). Në projekt dhe në ndërtim të integrohen pjesë me destinacion josportiv, në pronësi të shoqërisë anonime, pa kufizime në disponimin e të drejtave të pronësisë, me qëllim plotësimin e destinacionit të stadiumit të modernizuar.”

“1/2. Shoqëria anonime mund të iniciojë procedura përzgjedhjeje, financimi, dhe negociimi për realizimin e projektit të stadiumit, përfshirë edhe pjesën me destinacion josportiv, me subjekte të interesuara, duke bërë pjesë të ofertës, të negociatave dhe transaksioneve me subjektet e interesuara për financimin dhe realizimin e projektit, pjesërisht ose tërësisht, edhe të drejtat ekskluzive të pronësisë për pjesën josportive, të treguar në pikën 1/1.

2. Aksionarët e kësaj shoqërie anonime të jenë shteti, i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për ekonominë, dhe Federata Shqiptare e Futbollit.

3. Kapitali fillestar i shoqërisë së re është vlera e Stadiumit Kombëtar “Qemal Stafa”, në shumën prej 7 112 117 000 (shtatë miliardë e njëqind e dymbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekësh. Raporti i aksioneve në krijimin e shoqërisë anonime të re është:

- 25% shteti, i përfaqësuar nga i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për ekonominë;
- 75% Federata Shqiptare e Futbollit.

Në kapitalin e shoqërisë të përfshihet edhe vlera e truallit me sipërfaqe prej 2660 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) m², pjesë e pasurisë 7/6 dhe 6/24, në zonën kadastrale 8160 Tiranë.

4. Krijimi i shoqërisë anonime do të jetë pa afat.

5. Emërtimi i shoqërisë të vendoset në aktin e themelimit, me marrëveshje ndërmjet

¹ VKM nr.79, datë 2.2.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.32, 4 prill 2011.

VKM nr.715, datë 16.10.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.147, 19 nëntor 2012.

VKM nr. 1092, datë 18.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.247, 12 janar 2016.

VKM nr.728, datë 8.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.226, 19 nëntor 2017.

aksionarëve.

6. Autorizohet ministria përgjegjëse për sportin, në zbatim të këtij vendimi, për themelimin dhe krijimin e shoqërisë anonime, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

7. Pas përfundimit të procedurave ligjore në fuqi për administrimin e pasurive të shoqërive anonime me aksionar të vetëm shtetin, kalimi i stadiumit kombëtar “Qemal Stafa” në kapitalin e shoqërisë anonime të bëhet pa asnjë barrë apo detyrim ndaj të tretëve.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për kryerjen e procedurave për kalimin e stadiumit kombëtar “Qemal Stafa” në kapitalin e shoqërisë aksionare, që krijohet sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha